



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Mbledhja nr. **01/2025**

Data: **04 janar, 2025. Ora: 12:00**

Vendi: **Selia e KQZ**

Kryesues i KQZ-së: Kreshnik Radoniqi.

Anëtarët e KQZ-së: Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Sami Hamiti, Alban Krasniqi, Ibrahim Selmanaj, Fazli Stollaj, Gordana

Në takim ishin të pranishëm: Llaban, Qemailj Kurtis, Mufera Shinik

U.D. Drejtori i SKQZ dhe Drejtor i ZRCKFSP: Besnik Buzhala

Përkthyes: Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr. 70 dhe 71/ 2024

3. Aktivitetet e Zyrës

- Rekomandim për de certifikimin e kandidatit të subjektit politik të certifikuar

Partia Balli Kombëtar Demokrat Shqiptar, Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, 9 shkurt 2025

3. Këshillat e KQZ

3.1. Këshilli për Operacione Zgjedhore

3.1.1. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për caktimin e numrit maksimal të votuesve në vendvotime.

3.1.2. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për numrin e vendvotimeve në qendrat e votimit me kusht

3.1.3. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për mos përfshirjen e 915 votuesve pas verifikimit me Departamentin e Pensioneve dhe Agjencinë e Statistikave të Kosovës.

3.1.4. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për vlerësimin e qendrave të votimit në përfaqësi diplomatike që kanë numër të vogël të votuesve të regjistruar.

3.1.5. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të verifikimit të votuesve të regjistruar për votim jashtë Kosovës.

3.1.6. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për ndryshimin e lokacionit të QV-së 1710 komuna Pejë

4. Të ndryshme

1.Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kryetari Radoniqi, bëri hapjen e mbledhjes dhe paraqiti agjendën. Arianit Elshani propozoi heqje të disa pikave nga rendi i ditës, dhe propozoi si pikë të re certifikimin e listës votuese. (Incizimi nuk është në rregull, dhe nuk kuptohet...!)

Në fund, u votua agjenda me 11 vota për. U miratuan me 11 vota për edhe procesverbalet e mbledhjes nr. 70, dhe 71/ 2024.

2. Aktivitetet e Zyrës

Rekomandim për de certifikimin e kandidatit të subjektit politik të certifikuar: Partia Balli Kombëtar Demokrat Shqiptar, Zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës, 9 shkurt 2025:

Besnik Buzhala: Zyra më 31 dhjetor, ka pranuar përmes imellit kërkesën e kandidatit të certifikuar Agim Elezi me numër rendorë nr. 14 nga subjekti Partia Balli Kombëtar Demokrat Shqiptar dhe, ka kërkuar tërheqjen nga lista për arsye personale. Pas tërheqjes, këtij subjekti i është dhënë mundësia që ta bëjë ri renditjen e kandidatëve në listë. Elezi, është zëvendësuar me kandidatin Adam Dreni me nr. 95. Zyra, rekomandon që të de certifikohet kandidati Agim Elezi.

Kreshnik Radoniqi: Kush është për këtë de certifikim ?

Me 11 vota për, de certifikohet kandidati Agim Elezi me nr. 14 nga lista e kandidatëve për deputet në Kuvend nga subjekti politik Partia Balli Kombëtar Demokrat Shqiptar.

3. Këshillat e KQZ

Këshilli për Operacione Zgjedhore

1. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për caktimin e numrit maksimal të votuesve në vendvotime:

Arianit Elshani: E kemi shqyrtuar në këshillë këtë pikë, duke u bazuar në ligjin për zgjedhjet e përgjithshme, tha z. Elshani. Ai, potencoi se është një kufi prej 750 votuesish në vendvotim. Kjo, është diskrecion të KQZ-së dhe, mund të vlerësoj nëse ky numër mund të ulet ose rritet. Ne, nga shqyrtimi i trendit të daljes së votuesve, kemi arritur në përfundim që numri i votuesve në vendvotime në zonat rurale, të jetë 999 votues. Kjo, edhe për të zvogëluar numrin e vendvotimeve sepse, edhe do të jetë pak më vështirë organizimi i procesit, sidomos ajo që lidhet me prezencën e komisionarëve etj. Ndërsa, për zonat urbane, numri i votuesve në vendvotim do jetë deri në 950 votues.

Ky, është rekomandimi ynë si këshill.

Sami Kurteshi: Keni të dhëna, POR në zgjedhjet e fundit e të parafundit sa ka qenë numri maksima i daljes në një vendvotim ?

Arianit Elshani: Mesatarja ishte 340 votues për vv, mirëpo 342 ka qenë në aspekt të përgjithshëm. Tash, këtë kuotë e rritë pjesëmarrja edhe e komunave në veri. Kemi marrë në konsideratë edhe faktin se, votimi prej 10 kandidatëve në fletëvotim, e rritë edhe koston e kohës që duhet ndarë votuesit...

2.Shqyrtimi dhe miratimi i certifikimit të Listës Përfundimtare të Votuesve:

Arianit Elshani: Dje, ne kemi shqyrtuar edhe databazën e listës përfundimtare të votuesve, mirëpo nuk kishim qasje që të shohim secilin detaj. Ne, megjithatë kemi shqyrtuar disa raporte dhe është anulimi i disa votuesve të cilët janë verifikuar përmes telefonit si aplikues të regjistruar jashtë Kosovës. Këta janë evidentuar si raste të organizuara dhe të keqpërdorura. Të njëjtit janë anuluar. Kanë pas mundësinë të ri aplikojnë dhe të përfshihen në listë, por edhe të ankohen në instancat si PZAP dhe të njëjtit, të kthehen në listë. Ky numër është redaktuar në 104, 924 votues që do të votojnë jashtë vendit.

Lista përfundimtare e votuesve, po ashtu, i është nënshtruar verifikimit si Entit të Statistikave, MPB-së, dhe me Departamentin e Pensioneve të MEF. Kemi bërë verifikime, dhe janë ata që figurojnë me moshë shumë të shtyrë por, ata nuk janë në databazat e institucioneve si MEF. Figurojnë në Ekstraktin Civil. Lista përfundimtare prej 2 milion e 75 mijë e 868 votuesve s'i listë përfundimtare, nuk është krejt një listë e pastër sepse, ende figurojnë persona të vdekur sepse, qytetarët nuk e kanë bërë lajmërimin e tyre. Ndërsa, numri i regjistruar i votuesve jashtë Kosovës, është 104, 924 votues prej të cilëve, 84, 525 votues kanë zgjedhur të votojnë përmes postës dhe, 20, 399 votues kanë zgjedhur të votojnë fizikisht në përfaqësi diplomatike.

Rekomandojmë, tha z. Elshani që lista e votuesve të certifikohet.

Sami Kurteshi, pyeti rreth çështjes se si ata janë eliminuar.

Elshani, tha se janë dy raporte ku shpjegohen këto çështje. Mendoj që janë rreth 3500 persona që, kanë pasur probleme gjatë procedimit - aplikimit. Mendoj që shërbimi votues, ka bërë punë për lëvdatë...

Kreshnik Radoniqi: Me 11 vota për, certifikohet lista votuese.

3.Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për vlerësimin e qendrave të votimit në përfaqësi diplomatike që kanë numër të vogël të votuesve të regjistruar:

Arianit Elshani: E kemi shqyrtuar edhe këtë pikë. Ju e keni të bashkangjitur tabelën e votuesve që, votojnë në ambasada. Janë disa vende që kanë numër të vogël votuesish, më pak se 50 votues. Kemi konsideruar që ambasada në Podgoricë dhe Tiranë të mos hapen sepse, kanë numër të vogël votuesish: në të dyat, janë vetëm 8 persona. Këta persona, të alokohen në listën votuese. Kemi komunikuar edhe me MPJ-në, dhe jemi të gatshëm ti shqyrtojmë ato vende ku ka numër të vogël, ti mbylлим nëse ka numër të vogël.

Po ashtu, ne kemi shqyrtuar edhe Qendrat e Votimit që kanë 1800-2000 votues. Shërbimi votues, do të komunikoj me MPJ dhe, të shohim mundësinë që të kemi më pak votues duke krijuar më shumë vendvotime.

Si këshill, rekomandojmë që të mbylлен vendvotimet në dy përfaqësitë e lartpërmendura diplomatike: Tiranë dhe Podgoricë.

Alban Krasniqi: Shqetësimi im është me qendrat ku ka shumë votues. Për shembull, ka vende ku numri i votuesve mbërrin në 2000 por, janë ta zëmë vetëm dy vendvotime. Në qendrat diplomatike ose përfaqësi, mendojmë të zhvendosen edhe në objekte tjera. Kjo, përmes bashkëpunimit të qendrave tona diplomatike me shtetin ku ato janë. Pra, të mos kemi numër të madh që presin në radhë, por që askush të mos mbetet pa votuar. Pra, të gjenden hapësira të përshtatshme sepse, e dimë numrin e saktë të votuesve...

Në këtë pikë, diskutuan: Sami Kurteshi, tha se zgjedhja qëndron te qendrat alternative dhe e fundit, të inkurajohen votuesit të votojnë përmes postës. Alban Krasniqi i cili tha në formë të përkufizuar se KQZ-së i duhet një plan B. Pastaj, diskutoi edhe Ibrahim Selmanaj, i cili tha se duhet vepruar mbi bazën e ligjit dhe se, ekziston si mundësi që të shtohen vendvotimet.

Kreshnik Radoniqi: Kush është për që të mbylлен vendvotimet në dy përfaqësitë diplomatike, në Tiranë dhe në Podgoricë ?

Me 11 vota për, u miratua ky rekomandim.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i rekomandimit për ndryshimin e lokacionit të QV-së 1710 komuna Pejë:

Arianit Elshani, tha në vijim në raportin e tij se KOZ-i, e ka shqyrtuar dy herë këtë rekomandim për ndryshim të lokacionit të QV-së 1710, komuna Pejë. Ky lokacion shërben si shkollë por, aktualisht është në renovim. Bëhet fjalë për shkollën “7 Shtatori” në lokalitetin Vitomiricë. Votuesit, do të zhvendosen në shkollën ekomoike “Ali Hadri”. Bëhet fjalë për 10,640 votues. Ky veprim nuk është me iniciativën e KQZ-së por, se objekti është në renovim.

Diskutuan: Alban Krasniqi, që tha ndër të tjera se niveli komunal i pushtetit nuk është duke e kuptuar rolin e vetë që e ka obligim ligjorë për zhvillimi e procesit zgjedhor. Por, shtoi z. Krasniqi, KQZ minimumi që duhet të bëjë është që këta qytetarë të informohen me kohë dhe në masë të duhur. Këto probleme që po na paraqiten kohë pas kohe, vërtetë janë duke e rënduar procesin.

Në fund, me 11 vota për, u miratu ky rekomandim.

Arianit Elshani, tha në formë të njoftimit se lidhur me certifikimin e listës votuese se, janë në total:

- **903** Qendra të Votimit (QV),
- **2533** Vendvotime (VV),
- **38** Qendra të Votimit me Kusht (QV),
- **56** Vendvotime me kusht (VV).

Të ndryshme !

